



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1406/3 Prot.

Tiranë, më 05. 12. 2018

V E N D I M

Nr. 245, Datë 05. 12. 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me Nr. 163 Regj., datë 15.10.2018, e M. P., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Hetimit Tatimor, Rajoni Qendër, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*¹” dhe *gjendjes arsimore*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, M. P. ka filluar marrëdhëniet e punës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në pozicionin Inspektore në Drejtorinë e Hetimit Tatimor-Rajoni Qendër, me një kontratë 3 mujore (periudhë prove). Pas përfundimit të afatit 3 mujor, më datë 29.04.2015, ndërmjet saj dhe punëdhënësit është lidhur kontrata me afat të pacaktuar. Më datë 20.03.2017, ankuesja ka nënshkruar një kontratë 3 mujore (në periudhë prove) dhe është emëruar në pozicionin e Përgjegjëses së Zyrës së Monitorimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor-Rajoni Qendër. Me vendimin Nr. 33, datë 05.01.2018, ankuesja është liruar nga detyra e Përgjegjëses së Zyrës së Monitorimit dhe sërish me një kontratë 3 mujore, është emëruar në pozicionin e mëparshëm, Inspektore Hetimi, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor. Pas përfundimit të afateve të kontratës 3 mujore, ankuesja me shkresën Nr. 7170/2 prot., datë 20.04.2018, është vënë në dijeni nga punëdhënësi për mosrinovimin e kontratës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

¹ Mbështetur në kartat e anëtarësisë Nr. 06584, datë 07.10.2008 dhe Nr. 19, datë 03.02.2016, vërtetohet fakti i të qënurit anëtare e subjektit politik, Lëvizja Socialiste për Integrim. Gjithashtu, nga fotot bashkëngjitur ankesës, evidentohet pjesëmarrja e ankueses në aktivitetet politike të subjektit politik, Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim”.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën: KMD.

Ankuesja sqaron se gjatë të gjithë periudhës që ka punuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është vlerësuar pozitivisht dhe nuk është marrë asnjëherë masë disiplinore nga eprorët e saj.

Në analizë të situatës së sipërcituar, ankuesja sqaron se ulja në detyrë dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës, kanë ardhur si pasojë e bindjeve të saj politike, që pas largimit të subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, nga koalicioni me subjektin politik “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. Pas kësaj periudhe, fillimisht nga ana e drejtuesve të saj i është tërhequr vëmendja për heqjen e fotove të fushatës zgjedhore nga rrjetet sociale.

Lidhur me aktivitetin politik të saj, ankuesja ka sqaruar se gjatë viteve 2011-2016, ka mbajtur disa pozicione në subjektin politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, si: Nënkryetare e Lëvizjes Rinore për Integrim (2011-2015), anëtare e kryesisë së LSI³ (2012-2016), kandidate për deputete, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013, si dhe kandidate për anëtare e këshillit bashkiak Tiranë në zgjedhjet lokale të vitit 2015.

Në përfundim ankuesja ka shtuar se në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, Rajoni Qendër, pavarësisht kriterit arsimor (diplomë në Master Shkenca Ekonomike ose Juridike), vijnë të qëndrojnë në punë punonjës në pozicionet e Inspektorëve apo Përgjegjësve të Sektorëve, të cilët kanë përfunduar studimet për: Histori, Gjeografi, Shkenca Politike, Shkenca Sociale, Psikologji, IT, etj.

E ndodhur në këtë situatë, ankuesja pretendon se është diskriminuar nga punëdhënësi i saj gjatë procedurave për largimin nga puna, pasi arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës lidhen me bindjet politike.

Në përfundim, ankuesja kërkon nga Komisioneri, konstatimin e trajtimit të pabarabartë dhe diskriminues nga ana e punëdhënësit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen

³ Shkurtesë e Lëvizjes Socialiste për Integrim

shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Shkaku sipërcituar përbën shkak të mbrojtur nga ligji 10 221/2010, neni 1 dhe neni 3/1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet se “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Në nenin 12, “Ndalimi i diskriminimit”, pika 1, parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

- Me shkresën me Nr. 1406/1 prot., datë 25.10.2018 Komisioneri i ka kërkuar informacion dhe dokumentacion provues Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me pretendimin e M. P..

Me shkresën⁵ me Nr. 21845/1 prot., datë 06.11.2018 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka sqaruar Komisionerin lidhur me pretendimin e M. P., si dhe ndër të tjera ka theksuar faktin se: “M. P., ka ushtruar detyrat funksionale, në pozicionin Inspektor Hetimi Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor-Rajoni Qëndror, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, emëruar me vendim

⁴ Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1406/2 prot., datë 08.11.2018.

Nr. 33, datë 05.01.2018. Lëvizja në detyrë e M. P., është bërë konform dispozitave ligjore në fuqi, mbështetur në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”. Për rastin konkret, kemi një marrëdhënie juridike dypalëshe punësimi, ku shprehet vullneti i lirë i punëdhënësit dhe i punëmarrësit. M. P., ka pranuar pozicionin e punës, e cila ka nënshkruar kontratën e punës me afat të përcaktuar (3 mujore). Në përfundim të kontratës së punës dhe në respektim të dispozitave ligjor në fuqi, M. P. brenda afateve ligjore është njoftuar për mosrinovim të Kontratës së Punës.”

Në lidhje me arsimimin e punonjësve të Sektorit të Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor-Rajoni Qendror, të punësuar në momentin e mosrinovimit të kontratës së punës së M. P., Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve vuri në dispozicion kopje të dokumentacionit mbi arsimimin e punonjësve.

Nga ana tjetër, vetë subjekti ankues, nëpërmjet e-mailit të tij dërguar KMD-së⁶ më datë 30.11.2018, për arsye personale ka kërkuar ndërprerjen e procedurës hetimore nga ana e Komisionerit.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se pas kërkesës së subjektit ankues procedura e shqyrtimit të ankesës të ndërpritet.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), c), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe nenin 94, pika 1 e Kodit të Procedurës Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprerjen e procedurave të hetimit dhe pushimin e shqyrtimit të ankesës së M. P., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pasi ankuesja është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës.

⁶ Adresa e e-mailit të ankueses: @gmail.com

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike dhe gjendja arsimore)

(Fusha: Punësim)